



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE MITROVICË**

---

Numri i lëndës: 2022:188360  
Datë: 23.10.2024  
Numri i dokumentit: 06339511

**PPP.nr.292/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, si përmbartimore me gjyqtarin individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunuesin profesional Eron Prekazi, në çështjen juridike të kreditorit KUR MITROVICA Sh.A., me seli në Mitrovicë, kundër debitorit S. Sh., me adresë në Sh.-ana e majtë-Komuna e M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Faik Jashari, avokat me seli në Mitrovicë, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej ... €, gjykata duke vendosur sipas prapësimit të parashtruar nga debitori me datë ..., kundër Urdhërit mbi lejimin e Përmbartimit P.nr.1413/2018, gjykata jashtë seancës gjyqësore, me datën 23.10.2024, nxjerr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** prapësimi i debitorit S.Sh. nga Komuna e M., ashtu që:
- II. **SHFUQIZOHET PJESËRISHT** Urdhëri mbi lejimin e Përmbartimit ... i datës ... për periudhën kohore ... e gjerë me ... në shumë prej ... €, dhe
- III. **DETYROHET** debitori Sejdi Shala nga Mitrovica që kreditorit KUR MITROVICA Sh.A., me seli në Mitrovicë, në emër të borxhit për ujin e harxhuar për periudhën kohore ... e gjerë me ... t'ia paguaj shumën prej ... €, me kamatë ligjore në lartësi prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktvendimi e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 7 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

**Arsyetim**

Kreditori KUR MITROVICA Sh.A., me seli në Mitrovicë, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit kundër debitorit Sejdi Shala nga Mitrovica, për pagesën e borxhit në emër të ujit të shfrytëzuar për periudhën kohore ... e gjerë me ..., në shumë totale ... €, me kamatë vjetore prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuara në propozimin për përmbartim të datës .... Organi përmbartues me Urdhërin P.nr.... të datës .... e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori Sejdi Shala nga Mitrovica, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim me shkrim, duke e kundërshtuar urdhërin për përmbartim për shkak se sipas

nenit 360 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, konsiderohet borxh i parashkruar. Andaj i propozon Gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të refuzohet urdhëri përmbarimor.

Kreditori në afatin e parashikuar ligjor ka bërë përgjigje në kundërshtimin e debitorit, duke i propozuar gjykatës që të njëjtin ta refuzoi si të pabazuar për faktin se fillimisht kreditori propozimin për përmbarim e ka filluar duke u mbështetur në dokumentin e besueshëm konform nenit 29, kurse sa i përket parashkrimit këtu kemi të bëjmë me ndërprerje të parashkrimit për arsyeje se debitori i ka pranuar rregullisht shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit nga Kompania, këtu sipas LMD-së, kemi të bëjmë me përtëritje të borxhit (Novacion), por debitori ka dashur të i ikë përgjegjësisive të tij dhe asnjëherë ne si kompani nuk kemi pranuar ankesë nga ana e debitorit se nuk janë duke i shkuar me rregull faturat për shpenzimet e ujësjellësit. Si provë përgjigjes ja bashkëngjisim ekstraktet e faturave ku shihet se debitori i ka pranuar faturat dhe ka bërë pagesa të kohë pas kohshme, andaj konsideroj se propozimi i kreditorit duhet të përmbushet konform nenit 27 par. 1 dhe 29 par. 1.2 dhe 1.3 të LPP-së.

Gjykata Themelore Mitrovicë, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP-së, vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i bazuar pjesërisht.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe lidhur me pretendimet e debitorit paraqet prapësim ku e kundërshton urdhrin përmbarimor, pretendimet e lartcekura gjykata i refuzoj si të pa bazuara, për faktin se kreditori propozimin për përmbarim e ka iniciuar në bazë të faturës-kartelës financiare të konsumatorit, i njëjti përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, shumën të cilën e ka obligim ta paguaj debitori dhe kohën për të cilën është krijuar ky detyrim. Me nenin 29 par. 3 të LPP-së, është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në rastin konkret dokumenti i besueshëm i përmbanë të gjitha elementet e parapara me dispozitën e cituar andaj përbën dokument të përshtatshëm për përmbarim.

Sa i përket pretendimeve të debitorit në prapësim se borxhi është parashkruar, gjykata gjeti se të njëjtat pretendime janë pjesërisht të bazuara, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori Sejdi Shala nga Mitrovica, për periudhën kohore 01.09.2004 e gjerë me 31.12.2016, është borxh i parashkruar, konform nenit 360 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se debitori ska bërë pagesa dhe se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraprakisht një marrëveshje për ri programim eventual të borxhit, në rastin konkret nuk kemi ndërprerje të rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 368 të LMD-së.

Kurse sa i përket borxhit për periudhën kohore ... e gjerë me ..., gjykata gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit, në raport me debitorin për këtë periudhe kohore, referuar nenit 360, paragrafi 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti, fillon të rrjedhë në fundin e atij viti, e që në rastin konkret për të gjitha kërkesat e arritura në vitin ... afati i parashkrimit ka filluar të rrjedh me ..., kurse për vitin ... nuk ka vjetërsim të borxhit-parashkrim, për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me datën ... me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 369 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por ka gjetur se të njejtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktvendimi.

Gjykata konform nenit 17 të LPP-së, përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore të LMD-së. Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, dhe konform dispozitave të nenit 3, 17, 29 paragrafi 1.3 dhe paragrafi 3, 69, 71 e 73 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, lidhur me nenin 360 paragrafi 1 dhe 2, dhe 368, 369 dhe 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**PPP.nr.292/2022, datë 23.10.2022**

**GJYQTARI**  
**Fuad Haliti**

**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate.